



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.630/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Ferki Xhaferi dhe Rustem Thaqi anëtare, duke vendosur përkritazi me ankesat e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës dhe organizatës jo qeveritare BIRN dhe Internews Kosova, të paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 20.10.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**I. PRANOHEN** te bazuara ankesat Anr.630/2021 e datës 17.10.2021 e parashtruara nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Anr.658/2021 e datës 18.10.2021 e parashtruar nga BIRN dhe Internews Kosova, ndërsa Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje, i shqiptohet Gjobë në lartësi prej 1,000.00 euro (një mijë), në emër të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike - Thyerja e heshtjes zgjedhore.

**II. DETYROHET** subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, që gjobën e shqiptuar si në pikën I-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguajë në afat prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së këtij vendimi, nën kërcënim e shqiptimit të dënimit shtesë.

**III. I NDALOHET** Xhezide Selimi, me numër të letërnjoftimit 1231527334, në cilësinë anëtares së Vendvotimit QV2614D/01D, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, pjesëmarrja në zgjedhje, si kandidate apo edhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhore për periudhën kohore, në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite, nga dita e marrjes së vendimit.

## A r s y e t i m

Me datë 17.10.2021, PZAP-i, ka pranuar ankesat Anr.630 /2021 e datës 17.10.2021 e parashtruar nga Subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Anr.658/2021 e datës 18.10.2021, e parashtruar nga BIRN dhe Internews Kosova kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje në të cilat pretendohet se komisionerja Xhezide Selimi nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, e ka bërë postimin dhe shpërndarjen e materialeve zgjedhore në rrjetin social në Facebook ku ka postuar një fotografi duke votuar dhe duke i ftuar qytetarët që të dalin dhe të votojnë numrin 144. Gjithashtu parashtruesi i ankesës BIRN dhe Internews Kosova kanë theksuar se njëjta është komisionere në Gjilan e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje.

Me këtë rast paraqitësi i ankesës thekson se është bërë shkelje e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Parashtruesit e ankesave si provë kanë bashkangjitur fotografi të printuar në cilësi të provave materiale.

Në përgjigjet në ankesë sa i përket ankesave të parashtruara, Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje deklaroi se ankesa është e pa bazuar për arsye se në ankesën e paraqitur nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës nuk dëshmohet se qytetarja Xhezide Selimi është komisionere nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmërisë së ankesave dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, provave materiale - fotografive, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Ankesa është e bazuar**

Paneli, pas vlerësimit të pretendimeve në ankesa A.nr.630 /2021 e datës 17.10.2021 dhe Anr.658/2021 e datës 18.10.2021, të cilat për nga përmbajtja janë të njëjta dhe të gjitha ankesat janë paraqitur kundër subjektit të njëjtë politik Lëvizja Vetëvendosje, Paneli bazuar në nenin 8 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave Nr.02/2015, të PZAP-it, në të cilën përcaktohet se: *“Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave kryesuesi i panelit vendimmarrës mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato ankesa të trajtohen me një vendim”*, bëri bashkimin e ankesave dhe për të njëjtat vendosi me një vendim, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga shkresat e lëndës shihet se subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, përkatësisht komisionerja e këtij subjekti Xhezide Selimi, gjatë ditës së votimit në rrjetin e saj social Facebook ka bërë fushatë zgjedhore dhe ka udhëzuar që të votohet subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje me numër 144, të apostrofuuar në ankesë ku me këtë veprim ka bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore.

Paneli, konform nenit 8 par. 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr. 02/2015, ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës, dhe gjeti se të njëjtat janë të bazuara, për faktin se në llogarinë e Facebook-ut, të komisioneres së Lëvizjes Vetëvendosje Xhezide Selimi ashtu siç pretendon paraqitësi i ankesës, në ditën e votimit kanë hasur në fotografi të postuar me të cilën bënë thirrje që të votohet subjekti i caktuar, ku me këtë veprim kanë bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore.

Pretendimet e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, se nuk vërtetohet se Xhezide Selimi është komisionere e Lëvizjes Vetëvendosje, Paneli i vlerësoi si të pa bazuara për arsye se nga fotoja e paraqitur në ankesë shihet se e njëjta bart ID, me të cilën indentifikohet si komisionere e subjektit politik dhe e njëjta bënë thirrje që të votohet numri 144. Gjithashtu PZAP, ka bërë kërkesë në KQZ, për verifikimin e komisionerës në fjalë dhe nga përgjigja e dhënë nga PZAP, rezulton fakti se e njëjta është komisionere e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje në Komunën e Gjilanit.

Paneli, vendimin e tij e mbështet në dëshmi të qarta dhe bindëse, konform nenit 117 par.3 të LZP-së, andaj nuk i mori parasysh pretendimet e paraqitësit të përgjigjes në ankesë, pasi që nga ana e tyre nuk u ofrua ndonjë dëshmi e cila argumenton pretendimet e tyre.

Andaj Paneli, duke iu referuar të cekurave më lart dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së, konstaton se subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje perkatesisht komisionerja e këtij subjekti Xhezide Selimi është përgjegjëse për veprimet e saj, pasi që me veprimin e lartëcekur ka shkelur nenin 36 paragrafi 1 pika b) të LZP-së, që përcakton veprimet e ndaluara para procesit të votimit ku thuhet se 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja e fushatës në çfarëdo mënyre.

Paneli, me rastin e shqiptimit të gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, u mbështet në dispozitat e lart cituara, e në veçanti duke marr parasysh rrethanat e rastit siç janë: natyra e

shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj, në procesin zgjedhor, shkallën dhe peshën e shkeljes, faktin se subjekti politik të cilit i është shqiptuar gjoba Levizja Vetvendosje ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme dhe shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, vlerëson se gjoba e shqiptuar si masë, përveç aspektit të dënimit në raport me subjektin që nuk e ka respektuar Kodin e Mirësjelljes, shërben edhe si masë preventive që në të ardhmen subjektet politike të përmbahen nga veprimet e tilla që bien ndesh me rregullativën ligjore, që cenojnë të drejtën apo lirinë e votimit, në mënyrë që të sigurohet klimë e qetë dhe e përshtatshme për votim të lirë dhe të pa ndikuar si bazament i një procesi demokratik zgjedhor.

Nëse subjekti të cilit i është shqiptuar dënimi nuk e paguan të njëjtin brenda afatit të përcaktuar në dispozitiv të tij, atëherë në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së, subjektit do ti shqiptohet dënim shtesë. Ky paralajmërim për dënim shtesë është përcaktuar me nenin 120.2 të LZP, i cili përcakton: “ 120.2 Dështimi për të paguar dënimin apo për t’ju bindur një urdhërese të PZAP-it brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e PZAP-it, është një shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i. ”, ashtu siç është vendosur në pikën II, të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli, me rastin e vendosjes si në pikën -III-, të dispozitivit të këtij vendimi, është vendosur duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 120 par.3, pika d), të LZP-së, në të cilin parashihet se: “Në rast se ka ndodhur një shkelje e këtij ligji ose rregullave zgjedhore e cila e minon integritetin e zgjedhjeve PZAP-i, mundet d) Ndalojë një individ të marr pjesë në zgjedhjet e mbajtura nën autoritetin e KQZ-së, si kandidat apo edhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, për një periudhë kohore që nuk u kalon gjashtë (6) vite”. Për më tepër neni 34 i LZP-ës, ka përcaktuar se, ndalohet inkurajimi, mbështetja ose miratimi i dhunës ose kërcënimeve me dhunë apo kanosje gjate procesit zgjedhor.

Paneli, mbi bazën e të dhënave të lartcekuar në mbështetje të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitja**

**Anr.630/2021 më datë 20.10.2021**



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në afat prej 24 orë nga dita e pranimit të këtij vendimi.